



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 1288/24 prot.

Pogradec, më 31 . 03 .2026

**VENDIM**

**NR. 32 , DATË 30 .03 .2026**

**PËR  
“PËRJASHTIMIN E PËRKOHSHËM NGA TARIFAT VENDORE  
PËR SUBJEKTET QË USHTROJNË AKTIVITET NË ZONËN  
HISTORIKE A, PËR T’I DHËNË MUNDËSI ZHVILLIMI KËSAJ  
ZONE”.**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 133, datë 11.12.2023 për “Miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec”, i ndryshuar, relacionit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë përjashtimin e përkohshëm nga tarifat vendore për subjektet me xhiro vjetore 0-2 milion lekë, që ushtrojnë aktivitet në zonën “Naim Frashëri” dhe “Topleci”, përveç kategorisë “Profesione të lira” dhe kategorisë “Për çdo subjekt ndërtimi, shërbime në ndërtim. materialesh inerte, miniera me aktivitet në territorin e qytetit /Njësi Administrative”, për t’i dhënë mundësi zhvillimi zonës.



2. Përfundimi nga tarifave vendore do të zbatohet për periudhën, nga data 01.06.2026 deri në datën 01.06.2028.

3. Për zbatimin e këtij vendim ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike.

**KRYETARE E KËSHILLI**  
**Manjola KAMOLLI**

1. Miratuar me 21 vota

2. Vota Pro 21

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më date 30.03.2026

